

Në bazë të Programit për aktivitetet në fushën e sportit dhe të rinjve në Qytetin e Shkupit për vitin 2021 (Lajmëtari zyrtar i Qytetit të Shkupit nr. 15/20), Kryetari i Qytetit të Shkupit shpall:

THIRRJE PUBLIKE

për shpërndarjen e mjeteve buxhetore për financimin e programeve, projekteve, aktiviteteve dhe manifestimeve për të rinj me interes për Qytetin e Shkupit për vitin 2021

Për realizimin e interesave publike të të rinjve, Qyteti i Shkupit shpall Thirrje publike për financimin e programeve dhe projekteve për të rinj me interes për Qytetin e Shkupit për vitin 2021.

Aktivitetet, programet dhe manifestimet për të rinj dhe mjetet financiare për realizimin e tyre, Qyteti i Shkupit i përcakton me programin vjetor gjë me të cilën shpreh interesin e vet dhe nevojat në këtë sferë.

Programet dhe projektet, manifestimet dhe aktivitetet duhet të sigurojnë zhvillimin, stimulimin dhe prezantimin e vlerave shoqërore të të rinjve dhe arritjet për përmirësimin e jetës së të rinjve në nivel të qytetit të Shkupit.

Mjetet për financimin e programeve dhe projekteve do të sigurohen nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2021.

Në përputhje me dispozitat ligjore dhe kriteret për përcaktimin e programit për sport dhe të rinj dhe për sigurimin e mjeteve financiare për realizimin e tyre, Qyteti i Shkupit me programin për aktivitetet nga fusha e të rinjve në qytetin e Shkupit për vitin 2021, do të mbështesë:

- Inkurajimi i të rinjve për pjesëmarrje aktive në shoqëri nëpërmjet afirmimit dhe mbështetjes së aktiviteteve rinore, punës rinore dhe arsimit joformal në territorin e qytetit të Shkupit.
- Inkurajimi i lidhjeve, shoqatave dhe formave të tjera të bashkëpunimit për të marrë pjesë në krijimin dhe zbatimin e politikave rinore, duke përfshirë forcimin e kapaciteteve të shoqatave rinore në territorin e qytetit të Shkupit.
- Sigurimi i kushteve për shfrytëzim aktiv dhe cilësor të kohës së lirë të të rinjve.
- Inkurajimi i të rinjve për të marrë pjesë në aktivitete sportive dhe rekreative me theks në kultivimin e shprehive të shëndetshme jetësore.
- Inkurajimi i aktiviteteve vullnetare tek të rinjtë, si dhe organizimi i seminareve dhe edukimeve.
- Inkurajimi i aktiviteteve në fushën e kulturës dhe artit në territorin e Qytetit të Shkupit.
- Mbështetja e aktiviteteve dhe projekteve për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe rregullimit hapësinor në Shkup.

- Nxitja e të rinjve në krijimin e ideve nga fusha e teknologjisë informatike.

Aplikimet për marrjen e fondeve nga Thirrja publike për të rinjtë shqyrtohen nga një komision i formuar nga kryetari i Qytetit të Shkupit.

Mjetet ndahen nga Buxheti i Qytetit të Shkupit nga Programi për aktivitetet në fushën e sportit dhe të rinjve në Qytetin e Shkupit për vitin 2021, në vlerën 2.500.000.00 denarë për shoqatat civile, organizatat joqeveritare, fondacionet dhe personat e tjerë juridikë, si dhe në vlerën 600.000,00 denarë për personat fizikë.

Afati i realizimit të projektit:

Projekti me të cilin do të konkurrohet dhe që do të zgjidhet, domethënë, projekti i plotë ose faza përfundimtare e projektit duhet të përfundojë më së voni deri më 10.12.2021.

I

Programet dhe projektet e propozuara, aktivitetet programore dhe manifestimet, përveç arsytimit duhet të përmbajnë edhe propozim- konstruksionin financiar, në të cilin do të theksohen mjetet që kërkohen nga Buxheti i Qytetit të Shkupit, si dhe mjetet e siguruar nga burime të tjera.

II

Përveç fushave të theksuara, fletëparaqitjet e depozituara duhet të plotësojnë qëllimet dhe kriteret të cilat janë dhënë të bashkëngjitura në Thirrjen publike, e cila është shpallur në ueb-faqen zyrtare të Qytetit të Shkupit www.skopje.gov.mk

III

Në procedurën për shpërndarjen e mjeteve buxhetore nga Programi për aktivitetet në fushën e sportit dhe të rinjve në qytetin e Shkupit për vitin 2021, do të pranohen ato programe dhe projekte, aktivitete programore dhe manifestime, të cilat në bazë të kriterëve të specifike do të sigurojnë më së paku 60 pikë.

IV

Në Thirrje publike, të drejtë për pjesëmarrje kanë:

1. shoqatat civile, organizatat joqeveritare, fondacionet si dhe personat e tjerë juridikë dhe fizikë, të cilët e kanë selinë në territorin e Qytetit të Shkupit, përkatësisht personat fizikë duhet të jenë banorë të Shkupit dhe në moshën nga 16 deri në 29 vjeç dhe
2. Personat fizik që janë banorë të qytetit të Shkupit të moshës 16 deri më 29 vjeçar.

Paraqitja në Thirrjen publike kryhet me depozitimin e fletëparaqitjes së plotësuar (aplikimi). Aplikuesi, përveç fletëparaqitjes, detyrimisht duhet të depozitohë edhe dokumentet e mëposhtme:

Shoqatat civile, organizatat joqeveritare, fondacionet dhe personat e tjerë juridikë të depozitojnë:

1. Aktvendim për regjistrim në Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut.
2. Gjendje vijuese për regjistrimin e veprimtarisë jo më të vjetër se gjashtë muaj, të lëshuar nga Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut.
3. Vërtetim për xhiro-llogari të hapur dhe aktive në bankë.
4. Aplikacion të plotësuar.

Personat fizikë

1. Biografi e shkurtër dhe CV e aplikuesit
2. Kopje e llogarisë së transaksionit
3. Kopje e letërnjoftimit (Për të miturit kopje të letërnjoftimit të prindit / kujdestari)
4. Aplikacion i plotësuar.

V

Të dhënat e nevojshme si dhe propozim programet dhe projektet, aktivitetet programore dhe manifestimet, me konstruksionin financiar, duhet të depozitohen në një fletëparaqitje të veçantë e cila mund të merret në Arkivin e Qytetit të Shkupit (baraka 16) ose të shkarkohet nga ueb-faqja zyrtare e Qytetit të Shkupit www.skopje.gov.mk

Thirrja publike **zgjat 15 ditë**, nga dita e shpalljes në mjetet e informimit publik dhe në ueb-faqen e Qytetit të Shkupit www.skopje.gov.mk

Thirrja publike shpallet më **15.02.2021** dhe zgjat deri më **01.03.2021**.

Fletëparaqitjet duhet të depozitohen pranë Qytetit të Shkupit, nëpërmjet postës në adresën: Bul. "Ilinden" numër 82, 1000 Shkup, ose në Arkivin e Qytetit të Shkupit (baraka 16), më së voni deri më datën **01.03.2021** deri në orën **15:00** të ditës së fundit të përfundimit të Thirrjes publike, me emërtimin "**Thirrje publike për shpërndarjen e mjeteve buxhetore për financimin e programeve dhe projekteve për të rinj me interes për Qytetin e Shkupit për vitin 2021**".

Fletëparaqitjet depozitohen në zarf të mbyllur dhe të vulosur, pa shënuar subjektin ose personin fizik, i cili depoziton fletëparaqitjen.

Fletëparaqitjet e parregullta të cilat nuk janë dorëzuar në mënyrën që kërkohet në tekstin e mësipërm, që përmbajnë dhëna të paplota dhe dokumentacion jo të plotë, si dhe ato që nuk do të depozitohen në afatin e caktuar, nuk do të shqyrtohen.

Informacione plotësuese mund të merren në tel:

02/ 3297-238 dhe 3297-320.

QYTETI I SHKUPIT